



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:252273

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05459680

**C-IV-14-6645**

*Ankuesi*

**A J Shtime**

*Përfaqësuar nga Av: D B, Ferizaj*

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 14 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZHET ankesa si e pabazuar**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI057-0256, i datës 15 korrik 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 21 tetor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. GJI057-0256 të datës 15 korrik 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), me të cilin ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën maj - tetor 1990, në shumë prej 1,108.00 Euro, nga NSH “Eurometal” (në likuidim).

Ankuesi pohoi se nëse organet e agjencisë do ti kishin shqyrtuar me kujdes shkresat e lëndës, atëherë do të kishin konstatuar se ankuesi është larguar nga marrëdhënia e punës me vendim të organeve kompetente, që do të thotë se me vendimin e organizatës së lartpërmendur. Po ashtu ankuesi pohoi se agjencioni gabimisht ka zbatuar afatet ligjore edhe për faktin që është thirrë në një ligj i cili nuk ka qenë i zbatueshëm në vitin 2013 pra është thirrur në dispozitat e nenit 608 të

Ligjit për Punën e Bashkuar të vitit 1976 të aplikueshëm sipas nenit 1 të rregullores së UNMIK të vitit 1999/24 në lidhje me ligjin e aplikueshëm në Kosovë.

Me 20 dhjetor 2023, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se detyrimi i NSH për të paguar ankuesin nuk ka lindur asnjëherë, asnjë vendim gjyqësor nuk e ka shfuqizuar vendimin e NSH për të larguar ankuesin nga puna në vitin 1990 dhe se vendimi i largimit nga puna është ende në fuqi. Më tej, e paditura pohoi se edhe nëse një detyrim i tillë ka ekzistuar ndonjëherë, ai është shuar përmes parashkrimit në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

### **Arsyvetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në pajtim me nenet 2.4 dhe 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore, dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

*kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;*

Gjykata gjen se neni 608 i ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76) në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89) i cili ligj kishte hyrë në fuqi me 15 korrik 1989, konkretisht me nenin 74, i cili nen e plotëson Ligjin mbi Ndërmarrjet (GZ 77/88, (i cili kishte hyrë në fuqi me 01 janar 1989), konkretisht nenin 196 i cili qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha dispozitave të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, përveç dispozitave nga Kreu IV dhe Kreu i VI kaptina 2, dispozita e nenit 608 është e vendosur në Kreun e VI në kaptinën e 3, që do të thotë se është shfuqizuar me këtë ndryshim plotësim të ligjit. Ligji mbi Marrëdhënien e Punës i datës 14 prill 1989 dhe Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës i datës 28 shtator 1989, nuk kanë

paraparë dispozita të veçanta lidhur me parashkrimin e kërkesave monetare që lindin nga marrëdhënia e punës, megjithatë kjo nuk do të thotë se instituti i parashkrimit për kërkesat monetare ka mbetur i pa mbuluar me dispozita të tjera ligjore.

Gjykata vlerëson se, për kohen kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile lidhur me kërkesat periodike. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjinden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212 i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi.

Prandaj, shihet se parashkrimi për pagat e papaguara të kërkuara në këtë lëndë (pagat për periudhën maj-tetor 1990 ) ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD-ja ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar të pagave të pa paguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Sipas shkresave të lëndës dhe pohimeve të vet ankuesit, i njëjti kërkesën pranë AL-së e ka parashtruar lidhur me pagat e pa paguara për periudhën maj-tetor 1990, në shumë prej 1,108.00 Euro. Po ashtu nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi kërkesën për pagat e pa paguara e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 27 mars 2008, që është brenda afatit për parashtrimin e ankesave pranë AL-së, por një kërkesë e tillë veq se ishte e parashkruar vite më parë.

Ankuesi ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit të pretenduar pas çdo muaji të kaluar për të cilët nuk i është paguar paga, kështu që afati i parashkrimit ka rrjedhur për çdo muaj të pagave të pa paguara veç e veç.

Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënë ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së

drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore pagat e pa paguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar. Po ashtu, ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar faktin se ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore apo se ka parashtruar kërkesë për borxhin e pretenduar pranë organeve kompetente para ushtrimit të kërkesës pranë AL-së, kështu do të kishim edhe ndërprerje të afatit të parashkrimit.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore për ankesën e parashtruar, në shumë prej 20,00 Euro.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

---

Diellza Hoxha  
Gjyqtare